



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

[Shqip] Kërkesë për Shprehje të Interesit (2 pozita)

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) shpallë kërkesë për shprehje të interesit për 2 pozita për Njësitin e Menaxhimit të Projektit (NjMP), për Projektin “Banimi Social Adekuat” në Kosovë.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje për kredi me interes të ulët me Bankën e Zhvillimit të Këshillit të Evropës (BZHKE/CEB) për të përmirësuar infrastrukturën e banimit në Kosovë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përmes Projektit “**Banimi Social Adekuat**” do të jetë e adresuar në të drejtën thelbësore në nivel kombëtar, i cili ka qëllim që të përmbush kërkesat e banimit, si nga më të rëndësishme për qytetarët tanë.

Qëllimi i Projektit është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm social dhe të përballueshëm të banimit, duke u fokusuar në rritjen e numrit të njësive të banimit adekuat social. Qëndrueshmëria financiare do të nxitet përmes granteve të bazuara në performancë të komunave, ndërsubvencionimin e qirave të bazuara në të ardhura që përfituesit përfundimtarë që mund ti përballojnë dhe përmes partneriteteve të ardhshme midis komunave dhe sektorit privat, për të zhvilluar projekte të përziera banimi në tokën publike.

MMPHI është entiteti zbatues i projektit, në kuadër të së cilit do të veprojë **Njësi i Menaxhimit të Projektit (NjMP)**.

Njësi i Menaxhimit të Projektit (NjMP) do të sigurojë koordinim dhe integrim efektiv të të gjitha aktiviteteve të Projektit që lidhen me Banimin Social Adekuat. NjMP-ja shërben si organi qendror koordinues përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të përgjithshëm të Programit të Banimit Social Adekuat në Kosovë.

Dosja e shprehjes së interesit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar për aplikim mund të dorëzohet në Divizionin për Burime Njerëzore të MMPHI-së / Ndërtesa e ish Rilindjes / Kati 16 / Nr.zyrës 1617 / Prishtinë, nga data 28.07.2025 – 11.08.2025, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00 apo përmes postës fizike.

Më shumë informata për pozitat përkatëse mund të gjeni më poshtë:

1. **Konsulent për Media Sociale i Njësitit të Menaxhimit të Projektit.**
2. **Mirëmbajtës(e) e zyrës të Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP) për Projektin e Banimit Social Adekuat.**

Bazuar në nenin 17 paragrafi 5 nenin 47 dhe nenin 48 të Ligji NR. 08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë shtetërore, pikës 5 të Marrëveshjes se Kredisë në mes të Republikës së Kosovës Përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat” e ratifikuar me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes se Kredisë në mes të Republikës së Kosovës Përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat”, dhe dispozitave ligjore të Rregullores MF-NR. 05/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores MF-NR. 01/2016 për Administrimin e fondeve të Huamarrjes, e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren MF-NR 03/2017, shpall:

1. KONKURS

(PËR VEND TË LIRE PUNE)

Titulli i punës: Konsulent për media sociale i Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP) për Projektin e Banimit Social Adekuat.

I raporton: Divizioni për Banim, Drejtorit të Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe përfaqësuesit të Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE).

Kohëzgjatja e emërimit: 3 vjet, gjysmë - orari

Niveli i pagës neto: 450 EURO.

Pozita e kërkuar: 1

Afati kohor i aplikimit: 28.07.2025 - 11.08.2025,

Institucioni: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Departamenti: Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim.

Njësia: Njësi për Menaxhimin e Programit për Banim Social Adekuat (NjMP).

Vendi i punës: Prishtinë.

1. Vështrim i përgjithshëm i programit

Programi i Banimit Social Adekuat për Kosovën, i përpunuar në kontekstin e kornizës së Programit të Banimit Social, synon të krijojë një sistem afatgjatë të qëndrueshëm social dhe të banimit të përbalueshëm, për të përmirësuar kushtet e jetesës së familjeve dhe komuniteteve të cënueshme, të marginalizuara dhe me të ardhura të ulëta deri në mesatare në Kosovë.

Ky është një program 10-vjeçar i cili do të zbatohej në mënyrë graduale dhe në faza, bazuar në tre parime kryesore të miratuara me studimin e fizibilitetit: efektiviteti (përparimi i njerëzve,

plani, fitimi), barazia (duke përfshirë të varfërit dhe promovimin e drejtësisë), efikasiteti (duke rritur përsëritshmërinë dhe shkallëzueshmërinë).

Programi i Banimit Social Adekuat do të lëvizte në drejtimin e krijimit të një sistemi të qëndrueshëm social dhe të përballueshëm të banimit, duke u fokusuar në zgjerimin e stokut të banesave adekuate, me një qasje që mund të përsëritet, të shkallëzohet dhe të qëndrojë. Ndër shtyllat e masës, vëmendje i kushtohet krijimit të lagjeve me të ardhura të përziera, për të shmangur ndarjen shoqërore të grupeve të synuara me të ardhura të ulëta dhe formimin e "getove" me të ardhura të vetme. Qëndrueshmëria financiare do të nxitet përmes granteve të bazuara në performancë për komunat dhe individët, ndërsubvencionimin e qirave të bazuara në të ardhura që përfituesit përfundimtarë mund ti përballojnë, dhe përmes partneriteteve të ardhshme midis komunave dhe sektorit privat, për të zhvilluar projekte të përziera banimi në tokën publike.

Përcaktimi i sasisë dhe zbatimi i qëllimeve të programit, do të jetë i mundur më tej pasi të jenë përzgjedhur nën-projektet e dorëzuara nga komunat dhe të jenë marrë objektivat specifike të nën-projektit. Vlerësohet se rreth 2 000 familje mund të përfitojnë nga ky projekt, duke përfshirë ndërtimin e banesave të reja sociale, rinovimin e banesave ekzistuese të banesave sociale dhe rinovimin ose (ri)ndërtimin e shtëpive private të familjeve të cënueshme.

2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Njësitë e Menaxhimit të Projektit (NJMP) për menaxhimin e Projektit të Banimit Social kërkon të angazhojë një konsulent për media sociale për të identifikuar dhe vlerësuar përdorimin e rrjeteve dhe platformave sociale në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të programeve sociale në kuadër të Projektit të Banimit Social Adekuat.

Detyrat Specifike për konsulentin e mediave sociale do të përfshijë, por pa u kufizuar në, sa vijon:

Konsulenti/j për media sociale do të mbështesë NJMP dhe do të ndihmojë NJIP në ndarjen e informacionit, rritjen e ndërgjegjësimit për proceset përkatëse dhe promovimin e shërbimeve përkatëse për publikun e gjerë dhe grupet e interesit.

Konsulenti do të jetë i ngarkuar me këto detyra:

- të planifikojë dhe drejtojë zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të komunikimit dhe planeve të shpërndarjes në mënyrë që të ruajë perceptimet e favorshme të publikut dhe të palëve të interesuara;
- të krijojë dhe të mbajë marrëdhënie bashkëpunuese me përfaqësuesit e qeverisë, Qendrat për Punë Sociale, departamentet përkatëse komunale dhe grupet e interesit publik dhe palët e prekura nga Projekti;
- të mbështesë NJMP-në për të planifikuar angazhimin e qytetarëve duke ofruar informacione dhe konsultime, si dhe duke përfshirë reagimet e marra në projekt;
- Hartimi i një strategjie të personalizuar për çdo platformë (Web Faqe, Facebook, Instagram, LinkedIn, X, etj);
- Përpilimi i postimeve, artikujve, imazheve dhe videove për platformat e ndryshme;
- Publikimi i përmbajtjes në mënyrë të rregullt në të gjitha platformat dhe web faqen e Programit të Banimit Social Adekuat.

- Monitorimi dhe menaxhimi i ndërveprimeve me ndjekësit (komente, mesazhe, etj.).
- Intervista të akterëve dhe përfituesve të Programit të Banimit Social Adekuat dhe krijimi i reportazheve të shkurtra për publikim.
- Përpilimi i raporteve mujore dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim.
- Ruajtja dhe përmirësimi i imazhit të NjMP/MMPHI/BZHKE
- Vizibiliteti i dhënësit të kredisë BZHKE duke shfaqur në mënyrën e duhur emrin dhe logon e BZHKE (CEB) si dhe duke përgatitur dhe dërguar tek BZHKE (CEB) përmbledhje për publikim në web faqen e tyre.

3. Kërkesat e përgjithshme për punësim

- Diplomë Bachelor në Media dhe Komunikim/Gazetari/Komunikim Masiv dhe Gazetari/Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, ose fusha të ngjashme (diploma master është si avantazh);
- Minimumi 3 vjet përvojë profesionale në lidhje me komunikimin dhe 1 vit përvojë specifike/përkatëse në hartimin/prodhimin, publikimin dhe menaxhimin e informacioneve të shkruara dhe vizuale në platforma dhe media sociale që lidhen me shërbime, produkte apo projekte.
- Njohja me planifikimin e hartimit dhe ofrimit të fushatave informative;
- Të kuptuarit e mirë të medias dhe mjedisit të komunikimit të vendit;
- Aftësi për të shkruar lajme të mira;
- Aftësi të mira komunikimi, duke përfshirë aftësitë e mediave sociale dhe multimedias, aftësi të forta ndërpersonale dhe të rrjetëzimit;
- Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze thelbësore, gjuha serbe është përparësi;
- Njohuri në dizajn të prezantimit në rrjetet sociale
- Kërkohet njohja e funksionimit të kompjuterit;

4. Kërkesat e përgjithshme formale

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës, në përputhje me Ligjin për Gjuhët;
- Të ketë njohuri të avancuara të gjuhës angleze.

5. Kërkesa të përgjithshme (Njohuri, Aftësi, Cilësi, Kompetenca)

- Profesionalizëm;
- Aftësi të larta organizative;
- Orientimi në rezultat;
- Komunikimi dhe puna ekipore;

6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Shprehje e interesit;
- Letër motivimi;
- CV;

- Kopje të diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimor të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit të diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Vërtetim për përvojën e punës/certifikatë e lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, e cila përcakton pozicionin e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozicion;
- Kopje e letërnjoftimit/pasaportës;
- Vërtetim nga gjykata se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më i vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e dhënies.

7. Kriteret e vlerësimit:

- Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet sipas shpalljes së konkursit do t'i nënshtrohen vlerësimit përmes intervistimit me gojë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç është specifikuar në Ligj. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia e nën përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohen të aplikojnë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Dosja e shprehjes së interesit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar për aplikim mund të dorëzohet në Divizionin për Burime Njerëzore të MMPHI-së / Ndërtesa e ish Rilindjes / Kati 16 / Nr.zyrës 1617 / Prishtinë, nga data 28.07.2025 – 11.08.2025, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00 apo përmes postës fizike.

2. KONKURS

(PËR VEND TË LIRE PUNE)

Titulli i punës: Mirëmbajtës(e) e zyrës të Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP) për Projektin e Banimit Social Adekuat.

I raporton: Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP) për Projektin e Banimit Social Adekuat, Drejtorit të Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kohëzgjatja e emërimit: deri në 3 vjet, gjysmë orari

Niveli i pagës neto: 300 EURO.

Pozita e kërkuar: 1

Afati kohor i aplikimit: 28.07.2025 – 11.08.2025,

Institucioni: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Departamenti: Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim.

Njësia: Njësi për Menaxhimin e Programit për Banim Social Adekuat (NjMP).

Vendi i punës: Prishtinë.

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Njësitë e Menaxhimit të Projektit (NJMP) për menaxhimin e Projektit të Banim Social kërkon të angazhojë një Mirëmbajtës(e)/Pastrues(e) të ambienteve të punës – Zyrrave të Njësitit për Menaxhimin e Programit për Banim Social Adekuat (NjMP), në kuadër të Projektit të Banim Social Adekuat.

2. Detyrat Specifike për Mirëmbajtësin(en)/Pastruesin(en) do të përfshijnë, sa vijon:

Mirëmbajtësi(ja) do të angazhohet në mirëmbajtjen/pastrimin e Zyrrave të Njësitit për Menaxhimin e Programit për Banim Social Adekuat (NjMP).

Mirëmbajtësi(sja)/Pastruesi(sja) do të jetë i/e ngarkuar me këto detyra:

2.1 Pastrimi ditor

- Pastrimi i pluhurit nga të gjitha sipërfaqet (tavolina, pajisje pune, rafte, dritaret etj.) duke përdorur mjete dhe metoda të përshtatshme për secilin material;
- Fshirja dhe larja e dysHEMEVE me mjete dhe detergjentë të përshtatshëm për materialin përkatës;
- Dezinfektimi i sipërfaqeve të kontaktit (dorëza dyersh, tavolina pune, pajisje të përbashkëta etj.) me produkte të certifikuar dezinfektuese;
- Larja dhe dezinfektimi i tualeteve dhe lavamanëve;
- Zëvendësimi i materialeve harxhuese higjienike (letër higjienike, shampo, peceta etj.);
- Zbrazja dhe zëvendësimi i qeseve të mbeturinave çdo ditë të angazhimit.
- Të gjitha produktet pastruese dhe dezinfektuese duhet të jenë të certifikuar dhe të përshtatshme për ambientet e brendshme.

3. Kërkesat e përgjithshme për punësim

- Së paku 1 vjet përvojë pune të ngjashme;
- Aftësi të mira komunikimi dhe ndërveprimi;
- Njohja e gjuhës shqipe është thelbësore, gjuha serbe është përparësi.

4. Kërkesat e përgjithshme formale

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës, në përputhje me Ligjin për Gjuhët;

5. Kërkesa të përgjithshme (Njohuri, Aftësi, Cilësi, Kompetenca)

- Profesionalizëm;
- Aftësi organizative;

- Orientimi në rezultat;

6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Vërtetim për përvojën e punës, e cila përcakton pozicionin e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozicion;
- Kopje e letërnjoftimit/pasaportës;
- Vërtetim nga gjykata se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më i vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e dhënies.

7. Kriteret e vlerësimit:

- Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet sipas shpalljes së konkursit do t'i nënshtrohen vlerësimit përmes intervistimit me gojë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç është specifikuar në Ligj. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia e nën përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Dosja e shprehjes së interesit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar për aplikim mund të dorëzohet në Divizionin për Burime Njerëzore të MMPHI-së / Ndërtesa e ish Rilindjes / Kati 16 / Nr. zyrës 1617 / Prishtinë, nga data 28.07.2025 - 11.08.2025, çdo ditë pune nga ora 8:00 - 16:00 apo përmes postës fizike.